

Dr. Dorian Koçi

**LUFTA PËR MARRJEN E GARNIZONIT TË KOTËS
DHE NJË OBJEKT MUZEAL I GJENERALIT ITALIAN
ENRIKO GOTTI**

Lufta e Vlorës (3 qershor-3 shtator) në 1920 ishte një luftë kombëtare ku dolën në pah jo vetëm qëllimet e larta të rifitimit të tërësisë territoriale të Shqipërisë dhe të rifitimit të pavarësisë së plotë kombëtare, por edhe organizimi ushtarak e civil i popullsisë. Si të gjitha luftërat përveçse aspektit heroik ajo pati mes të tjerash dhe aspektin njerëzor, të të rënëve në luftë, trajtimin e robërve dhe të të zhdukurve që ende nuk kanë varr. Lufta e Vlorës u zhvillua në mënyrë frontale. Përballë ushtrisë së rregullt italiane, të përbërë nga dy divizione me 20 mijë ushtarë, u vunë forcat e çlirimit, të grumbulluara mbi baza vullnetare e që arritën në rreth 4 mijë veta. Veprimet luftarake të javës së parë i përballuan forcat e krahinës së Vlorës, pastaj morën pjesë edhe ato të ardhura nga krahinat e tjera të vendit. Në dy javët e para të luftimeve, kryengritësit shqiptarë patën 25 të rënë dhe mbi 150 të plagosur, kurse italianët 200 të vrarë, mbi 1000 të plagosur dhe rreth 1600 ushtarë e oficerë të zënë robër. Edhe pse këto shifra mund e duhen marrë me rezerva, pasi vinin nga pala shqiptare, në një kohë që pala italiane flet për pak të vrarë dhe dhjetëra të plagosur. Por fakti që në ditët e para të luftës kryengritësit shqiptarë bënë të dorëzoheshin garnizone mjaft të rëndësishme si Kota që drejtohej nga gjeneral Gotti, flet shumë për një udhëheqje popullore dhe kryengritës popullore shpesh edhe

me mungesa të shumta në armatim e fishekë.¹

Palët ndërluftuese kishin shkuar drejt konfliktit të armatosur pasi kishin konsumuar të gjitha mjetet e fundit edhe në formën e një ultimatumit për të shamgur gjakderdhjen. Pavarësisht faktit që Italia në vitet 1912-1913 kishte qenë një nga mbështetëset e pavarësisë së Shqipërisë, pas futjes së trupave të veta në Shqipëri në kuadër të Luftës së Parë Botërore përbënte tashmë një kërcënim për egzistencën e tërësisë territoriale të shtetit të pavarur shqiptar. Një muaj pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, forcat italiane nuk ishin tërhequr nga Shqipëria dhe për më tepër politika italiane kishte filluar të lëvizte gurët për të krijuar një qeveri proitaliane që do të bënte të mundur t'i siguronte një mandat mbi pjesën e hiterlandit të Vlorës të lakmuar nga qarqet imperialiste italiane. Në dhjetor 1918 u krijua Qeveria e Durrësit me Kryeministër Turhan Pashë Përmetin. Qeveria u formua prej 14 anëtarësh. Kjo qeveri do të kishte në përbërjen e saj këta emra: 1. Turhan Pasha (kryetar), 2. Preng Bib Doda (nënkryetar), dhe anëtarë: 3. Sami bej Vrioni, 4. Dr. Mihal Turtulli, 5. Myfit bej Libohova, 6. Imzot Luigj Bumçi, 7. Midhat bej Frashëri, 8. Luigj Gurakuqi, 9. Mehmet bej Konica, 10. Lef Nosi, 11. Mehdi Bej Frashëri, 12. Fejzi bej Alizoti, 13. Mustafa Kruja, 14. Pjetër Poga. Qeveria e Durrësit ishte nën ndikimin italian. Pro politikës së saj ishin Myfid Libohova, Fejzi Alizoti, Mehdi Frashëri, Sami Vrioni, Mustafa Kruja. Një traktat i fshehtë mes qeverisë së përkohshme të Durrësit dhe qeverisë së Italisë u nënshkrua nga ministrat Myfid bej Libohova, Fejzi bej Alizoti dhe këshilltarit të Legatës italiane në Shqipëri markezit Karl Durrazzo. Sipas tij, një komisar i lartë i Italisë kontrollonte dhe vendoste mbi punët e qeverisë shqiptare si dhe për vendimet me rëndësi si buxheti, ndërtimet, koncensionet, emërimet, pushime në administratë. Këtë qeveri Italia e konsideroi si një delegacion pranë qeverisë italiane, i cili pa lejen e Adetto Gobit nuk bënte asnjë shpenzim. Për më tepër tetë muaj më vonë

¹ Zaho Golemi, Ëngjëllush Njazi Avdulaj, *Udhëheqja e Luftës së Vlorës në të gjitha nivelet nga këndshikimi pas 100 viteve*, faqe 5, Aktet e Konferencës Shkencore për 100 vjetorin e Luftë së Vlorës.

politika italiane kishte filluar të marrë tipare të rrezikshme përsa i përket trajtimit të çështjes shqiptare. Më 29 korrik 1919 ishte nënshkruar marrëveshja Titoni-Venizelos, sipas së cilës Italia angazhohej të mbështeste në Konferencën e Paqes kërkesat greke për aneksimin e Korçës dhe Gjirokastrës, ndërsa Greqia do të mbështeste mandatin italian mbi Shqipërinë e cunguar nga ana territoriale, si dhe aneksimin e Vlorës prej Italisë.²

Në këto kushte, patriotët shqiptarë, duke parë se nuk mund të shprejonin në mbështetjen e ndonjë fuqie të huaj, rritën përpjekjet për organizimin e qëndresës kundër pushtuesve italianë. Vendimi për fillimin e luftës u mor nga përfaqësuesit e krahinës së Vlorës të mbledhur në Kuvendin e Barçallasë të 29 majit 1920, i cili, për organizimin e drejtimin të luftës zgjodhi komitetin “Mbrotjtja Kombëtare”. Thirrja e këtij Komiteti nga ana e kryetarit të tij, Osman Haxhiut për gjithë fshatrat se: “...ju bëjmë të ditur, se nevoja e rrezikut që ka marrë në sy Vlora dhe Atdheu na thërrasin për bashkim e kuvëndim në malin e Barçallasë më 29 të majit. Nxitoni të jini atje: Me lutje Osman Haxhiu”,³ bëri të mundur një bashkim kombëtar përsa i përket çështjes së Vlorës. Organizimi në rrafsh kombëtar u bë nga komitetet e «Mbrotjtjes Kombëtare» të krahinave të ndryshme të vendit edhe nga qeveria e Tiranës, e cila dha ndihmën e saj, megjithëse nuk mori pjesë zyrtarisht në luftë. Qeveria shqiptare e Sulejman Delvinës ndoqi një strategji të zgjuar dhe efikase. Ajo nxiti dhe mbështeti organizimin e një kryengritje popullore⁴ e cila nuk do të merrte karakterin e një lufte mes shtetit shqiptar dhe atij italian. Kështu qeveria e Tiranës synonte ti shmangej përgjegjësisë për shpërthimin e kësaj lufte dhe në të njëjtën kohë e la rrugën të hapur për të vijuar bisedimet diplomatike

² Paskal Milo, *Politika e Jashtme e Shqipërisë*, vëll.I (1912-1939), Toena, Tiranë, 2013, faqe 416-417.

³ Bardhosh Gace, *Osman Haxhiu*, Tiranë, 2001, faqe 105.

⁴ *Lufta e Popullit shqiptar për çlirimin kombëtar 1918-1920*, Vëllimi II, dok. nr.23, f. 379-380, *Letër e Ministrisë së Punëve të Brendshme dërguar prefekturës së Vlorës*, Tiranë, 25 qershor 1920; po aty, dok. nr. 326, f. 381. *Urdhër i Ministrisë së Punëve të Brendshme dërguar Eshref Frashërit në Elbasan për nisjen e municioneve në Vlorë*, Tiranë, 28 qershor 1920.

me italianët, të cilat ishin ndërprerë më 25 maj 1920, duke e vënë veten në rolin e ndërmjetësit midis kryengritësve dhe ushtarakëve italianë⁵. Vendosmëria e popullit shqiptar që tashmë po dëshmonte një pjekuri politike përsa i përket marrjes në dorë të fateve të tij dëshmohet dhe nga editoriali i gazetës “Drita” të Gjirokastrës, që ishte gazeta që pasqyroi në pjesën më të madhe të numrave të saj Luftën e Vlorës. “Vlora shkruhej në editorial nga patrioti Veli Hashorva që ishte editori i kësaj gazete, është tona dhe duhet të jetë. Se Vlora e bëri Shqipërinë, po ajo mund (edhe) ta prishij. Pra rreziku jonë vjen nga Vlora, dhe jeta e Shqipërisë varet atje. Nuk ka në shesh çështje të Toskërisë, Gjirokastrës, Shkodrës. Fati i këtyre viseve është i lidhur tok me atë të Vlorës. Këtë gjë duhet ta dijmë mirë dhe për të shpëtuar vendet që kanosen prej fqinjëve, a më mirë për të siguruar jetën e gjithë Shqipërisë, duhet që Vlora të jetë e Shqipërisë ashtu siç ka qenë”⁶.

Më 3 qershor, Komiteti “Mbrojtja Kombëtare” i Vlorës i drejtoi komandantit të forcave italiane, gjeneral Piancentin-it, një ultimatum në të cilin theksohej se populli shqiptar konsideronte si shkaktare të copëtimit të Shqipërisë vetëm Italinë e cila, me politikën saj imperialiste, këmbëngulte në aneksimin e Vlorës. Ultimatumi kërkonte që deri në mbrëmjen e 4 qershorit, komandanti italian të pranonte që Vlora me rrethinat e saj, t’i dorëzohej qeverisë shqiptare, në rast të kundërt, fjalën do ta kishin armët. Komandanta italiane nuk e përfilli ultimatumin dhe e nënvlerësoi forcën e kryengritësve shqiptarë. S. Piancentini pohonte se kryengritësit ishin një masë amorfe pa udhëheqje dhe pa disiplinë ndaj ish-in të parrezikshëm⁷. Ky nënvlerësim dhe mosmarrje në konsideratë të forcave kryengritësve shqiptare, që kishin në mes të tyre oficerë me përvojë, që kishin shërbyer në Perandorinë Osmane apo edhe prijës popullorë si Selam Musai,

⁵ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit të XX*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë 2019, faqe 76.

⁶ “*Valona e nostra dhe Vlora e Shqipërisë*”, Gazeta “Drita”, Shtypur në Gjirokastrë më datë 6 maj 1920, faqe 1.

⁷ M. Montanari, *Le truppe italiane in Albania*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, faqe 214-215.

Zigur Lelo, Sali Murati etj, do tu kushtonte shtrenjtë në pëprlasjen e armatosur që filloi në mbrëmjen e 5 qershorit. Sulmi që i menjëhershëm kundër të gjitha garnizoneve italiane, por më të fuqishme ishin në Kotë, kundër regjimentit të gjeneral Gotit, që mbrohej me fortifikata të betonuara dhe nga zjarri i artilierisë. Lufta e Kotës do ishte një nga luftrat më kryesore kundër italianëve, ku vetë Goti i kërkonte Piaçentinit përforcime. Italianët kishin bërë edhe përforcime me tela në bazat e tyre, të cilat i pengonin trupat shqiptare. Në këto momente u shfaq taktika popullore e prijësve të çetave kombëtare, Selam Musait e Zigur Lelos që vendosën gunat përmbi tela dhe kështu mundën të kalojnë mbi fortifikimet. Afër mëngjesit kryengritësit hynë brenda kazermave dhe i detyruan forcat italiane të dorëzoheshin. Në këto luftime u vra dhe gjenerali italian Enrico Gotti (Torino, 18 korrik 1867 - Drashovicë, 6 qershor 1920), hierarku më i lartë i ushtrisë italiane i rënë në këto luftime. Sipas kujtimeve të Riza Runës, komandant i çetës së Nivicës dhe pjesëmarrës në luftime, Gjeneral Gotti u vra brenda kampit ushtarak italian. Një ushtar italian, që u kap rob u dërgua tek gjeneral Gotti, i cili sapo doli në shkallë për të biseduar me R. Runën, u qëllua nga nivicioti Riza Canja sepse “nuk e kuptoi që ai dhe ushtria e tij po dorëzohej.”⁸

Karriera e gjeneral Gottit, përpara se të vinte e të dislokohej në Vlorë ishte një karrierë tipike e një ushtaraku, që reflektonte dhe ambiciet imperialiste të Italisë. Gjeneral Gotti lindi në Torino në 1867 dhe njëzet vjeç ai u dërgua në Eritrea me Regjimentin e 7-të të Këmbësoresisë “Cuneo”. Ai u dallua gjatë luftës së Saatit më 25 janar 1887, deri në fitimin e medaljes së bronzit për trimëri ushtarake. I promovuar në gradën toger, ai më vonë u bë një oficer ordinance i gjeneralit Antonio Baldissera dhe mori pjesë në manovrat ushtarake, që çuan në pushtimin e Asmara dhe Cheren. Ai u largua nga Shkolla e Luftës me gradën kapiten dhe u caktua në Regjimentin e 5-të Bersaglieri. I promovuar në kolonel në nëntor 1915 ai u vendos në komandën e Regjimentit të 4-të Bersaglieri, të cilin ai e drejtoi në aksionin kundër urës së Bodres në janar

⁸ Shyqyri Hysi, *Prefektura e Gjirokastrës në Luftën Kombëtare të Vlorës*, Edlora, Gjirokastrë, 2020, faqe 188.

1917 e cila i dha atij medaljen e dytë të bronzit. Pas përfundimit të luftës ai u dërgua për të komanduar Regjimentin e 72-të të Këmbësorisë “Puglie”, i vendosur në portin shqiptar të Vlorës. Rënia e gjeneral Gottit në luftime memorizohet në kujtesën muzeale përmes një objekti të veçantë që ndodhet në fondin e Muzeut Historik Kombëtar. Në fondin e Muzeut Historik Kombëtar gjendet një Kutia cigaresh me numër inventari 2814, e cila është përdorur prej gjeneralit italian Enriko Gotti. Kutia ka përmasat 9.5x8.5 cm. Ajo është dorëzuar në Muzeun Historik Kombëtar nga Nadire Qazimi në vitin 1985. Kutia ka mbi kapak inicialet RV, ndërsa brenda saj ka të gdhendur datat 1914, 1915, 1916 si edhe 26 firma dhe 10 emra qytetesh të Italisë. Sipas të dhënave të mbledhura rezulton se janë firmat e pjesëmarrësve në ceremoninë e gradimit të gjeneralit Enriko Goti.⁹

Gjeneral Gotti i përkiste shtresës së lartë të shoqërisë italiane. Ai ishte i martuar me Maria Bonaparte, vajza e Princit Napoleon-Carlo dhe Cristina Ruspoli, nga e cila nuk kishte asnjë pasardhës. Familja Napoelon-Carlo ishte pasardhëse e vëllait të Napoloen Bonapartit, kur ky i fundit e kishte caktuar vëllanë e tij të madh juristin Josef Bonaparti (1768-1844) si mbret të Napolit e Sicilisë (1806-1808). Vrasja e gjeneral Gottit nuk u konsiderua si një aksident, por si një vrasje e pabesë nga qarqet e politikës italiane. Një vit më vonë pas vdekjes së tij në 2 qershor 1921 ai do të dekorohet me medaljen e artë për trimërinë ushtarake me motivacionin e mëposhtëm: “Komandanti i një regjimenti në krye të mbrojtjes së përparuar të një kampi të ngulitur, megjithëse u gradua gjeneral, ai kërkoi të mos transferohej derisa të sqarohej dhe zgjidhej një situatë që pritej të ishte shumë kritike, për shkak të kryengritjes së vendit. Ai organizoi mbrojtjen e qendrave të përparuara të grumbullimit me shumë aftësi, duke lavdëruar punën e tij aktive në inspektime të vazhdueshme të rrezikshme të vetë qendrave dhe duke futur në garnizone më të dobëta, të shqetësuar nga malaria, një shpirt i fuqishëm luftarak. Sulmuar papritmas nga forcat pesëmbëdhjetë herë më të larta, ai drejtoi dhe mbajti për

⁹ Fondi i Muzeut Historik Kombëtar.



Kutia e duhanit e gjeneralit italian Enriko Goti

rreth dhjetë orë me guxim të pathyeshëm dhe një entuziazëm të admirueshëm një rezistencë ndaj fundit të hidhur aq efektiv sa që armiku u shkatërrua fjalë për fjalë dhe u detyrua të vononte investimin e kampit të ngulitur për disa ditë. Mbrojtësit e guximshëm mbetën pa municion dhe pa ujë, të vetmet dy pjesë në dispozicion të papërdorura, në mënyrë që të shmangnin shkatërrimin e plotë të garnizonit të varur që tashmë kishte pësuar humbje shumë serioze. Pasi ndërmori hapa për të shpëtuar flamurin dhe fondet e regjimentit, ai doli i vetëm dhe i paarmatosur për t'u marrë me kryengritësit, i vendosur të sakrifikoje veten për të shpëtuar vartësit e tij. Në këtë akt të zemërgjerësisë sublime, i vrarë pabesisht nga një prej udhëheqësve rebelë të egërsuar nga rezistenca e ashpër e jona, për të cilën ata me të drejtë e bënë heroizmin e gjeneralit më të guximshëm përgjegjës, ai sakrifikoi ekzistencën e tij fisnike Atdheut, të cilit i kishte kushtuar një jetë të tërë që shkëlqen me virtytet më të bukura të qytetarit dhe ushtarit. Dekreti Mbretëror 2 qershor 1921.¹⁰

Në motivacionin e dekorimit të gjeneral Gotti nga ana e Mbretërisë Italiane zbulohen të dhëna interesante përse i përket numrit të forcave kryengritëse që sulmuan por edhe për motivin e Luftës së Vlorës. Garnizoni i Kotës kishte rreth 700 ushtarë italianë dhe përmendja në motivacionin e dekorimit se gjeneral Gotti mbrojti garnizonin e tij “nga forcat pesëmbëdhjetë herë më të larta” tërthorazi dëshmon se numri i kryengritësve shqiptarë ishte rreth 10.500. Sigurisht që ky numër është i egzagjeruar pasi nga burimet arkivore e dokumentore numri i forcave shqiptare, që rrethuan garnizonin e Kotës përbëhej nga disa çeta luftëtarësh, më e madhja në numër 100 vetë. Luftimet për çlirimin e Kotës, Drashovicës dhe Mavrovës zgjatën rreth 10 orë. Në këto luftime u dallua çeta e Nivicës, e cila kapi rob dhe shtabin e ushtrisë italiane. Forcat kryesorë në këtë luftë ishin nga çetat e Salarisë, Nivicës, Gusmarit, Progonatit, Dukajt, Turanit, Toçit e Krahësit.¹¹

¹⁰ www.quirinale.it/onorificenze. Zëri Enrico Gotti.

¹¹ Shyqyri Hysi, *Prefektura e Gjirokastrës në Luftën Kombëtare të Vlorës*, Edlora, Gjirokastrë, 2020, faqe 188.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i përmendur në motivacionin e dekorimit të gjeneral Gottit është përmendja e strategjisë së përdorur nga forcat kombëtare shqiptare si prerja e ujit dhe bllokimit të furnizimit me municione dhe e numrit të saktë të orëve të luftimeve. Kjo strategji e mbështetur sa në taktikën e oficerëve shqiptarë, që kishin studiuar në akademitë ushtarake të Perandorisë Otomane po aq dhe në strategjinë e luftërave guerile popullore rezultoi të jetë një nga avantazhet më të rëndësishme të fitores. Mbrëmjen e 4 qershorit, në errësirën e natës, u prenë të gjitha linjat telefonike të Vlorës nga garnizonet në terren, duke paralizuar kështu ndërlidhjen italiane. Po ashtu, u prishën urat e rrugët, dhe u çarmatosën pa luftë të gjitha postat e karabinierisë, duke i mbajtur robër forcat italiane dhe duke i parapërgatitur për t'i çuar tek “Burgu natyror i Vajzës”. U vendos gjithashtu që sokëllima ose britma e luftës në sulm do të ishte një qeshja e madhe therëse e tallëse: “ha ha ha”, një sokëllimë e nxjerrë në kor dhe e paprerë me zë të fortë, që u përdor në sulm në mot me shi e breshër, për të nderur qentë kundër uqërve.¹²

Po kështu versioni i vrasjes së gjeneral Gottit në motivacionin e dekorimit të tij nga Mbretëria Italiane përputhet me kujtimet e atdhetarit Riza Runa, komandantit të çetës së Nivicës, por sigurisht kjo vrasje është përcjellë jo si vrasje aksidentale, por si një vrasje e pabesë. Në motivacionin e dekoratës së gjeneral Gottit përmendet se...pasi ndërmoi hapa për të shpëtuar flamurin dhe fondet e regjimentit, ai doli i vetëm dhe i paarmatosur për t'u marrë me kryengritësit, i vendosur të sakrifikoje veten për të shpëtuar vartësit e tij. Në këtë akt të zemërgjerësisë sublime, i çuar pabesisht nga një prej udhëheqësve rebelë të egërsuar nga rezistenca e ashpër e jona...Ky përcaktim me ngjyrim të diskursit orientalist të ndarë përmes kundërshtime leksikore (ushtri e rregullt-rebelë, paqësorë-të egërsuar) dëshmon se edhe një vit më vonë pas përfundimit të luftës së Vlorës, qarqet militariste italiane nuk e kishin përtypur lehtë disfatën e tyre në Vlorë. Por sigurisht jo të gjithë qarqet

¹² Zaho Golemi, Ëngjëllush Njazi Avdulaj, *Udhëheqja e Luftës së Vlorës në të gjitha nivelet nga këndshikimi pas 100 viteve*, Aktet e Konferencës Shkencore për 100 vjetorin e Luftës së Vlorës, faqe 4.

italiane mendonin njëlloj. Lufta Kombëtare e Vlorës me karakterin e saj antiimperialist shërbeu si katarsis edhe për shoqërinë italiane. E përditshmja “Piccolo giornale d’Italia” e përshkruante kështu Luftën e Vlorës më 12.6.1920: “Po jetojmë orë të tmerrshme. Të ngjethet mishtë nga pamja e mjerueshme e qytetit. Disa thonë se kryengritësit janë 5.000 vetë, të tjerë thonë 10.000 vetë, por asgjë nuk dihet me siguri. Është e pamundur të vërtetosh numrin e saktë të humbjeve tona, dhe ato të kryengritësve...”. Revolta më e rëndësishme ishte ajo e bersalierëve në qytetin-port të Ankonës, por edhe qytete të tjera italiane më 26-29.06.1920. Lëvizja nisi në një kazermë, kur një regjiment ushtarësh refuzuan të shkonin që të luftonin në Vlorë. Fakt është se kishte edhe kërkesa që shkonin deri në radikale në Itali, sikurse ishte thirrja e qershorit 1920 e partisë socialiste italiane dhe Konfedeata e Përgjithshme e Punës, që i drejtoheshin proletariatit të Italisë, që të ndalohej dërgimi i djemëve në luftë, duke deklaruar: “po e çojmë edhe një herë fort zërin: “Jashtë Vlorës”. Reagim të ashpër bënë edhe parlamentarët italianë brenda në parlament, kur dolën me parrullën: “Jashtë duart nga Shqipëria”¹³.

Historia sociale e Luftës së Vlorës, të rënëve dhe synimeve të arritura në rrafshet e tjera studimore është studiuar pak dhe meriton më shumë vëmendje. Për qarqet e politikës shqiptare ajo mbeti lufta ku atdhetarizmi e theoria sipas kryeministrit Sulejman Delvina që asht rrëfye në Vlorë do të ndriçojë faqet ma të famshme të historisë sonë kombëtare¹⁴, për qarqet e politikës italiane të kohës si lufta ku u gabua në taktikë kundrejt faktorit shqiptar. Por, ajo mbetet dhe një luftë e marrëdhënie ndërnjerëzore ku objektet e koleksionet historike mund të rrëfejnë pjesën tjetër të historisë.

¹³ Mbi influencën e ideve të tetorit në Shqipëri, Tiranë, 1957, faqe 52, 53; Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918-1920 (Përmbledhje dokumentash, Vëllimi II, Tiranë, 1976, dokumenti 297, faqe 253, si dhe dokumenti 329, faqe 384 cituar sipas Zaho Golemi, Ëngjëllush Njazi Avdulaj, *Udhëheqja e Luftës së Vlorës në të gjitha nivelet nga këndshikimi pas 100 viteve*, Aktet e Konferencës Shkencore për 100 vjetorin e Luftës së Vlorës, faqe 5.

¹⁴ Shyqyri Hysi, *Prefektura e Gjirokastrës në Luftën Kombëtare të Vlorës*, Edlora, Gjirokastrë, 2020, faqe 3.

Bibliografi:

- Bardhosh Gace, *Osman Haxhiu*, Tiranë, 2001, faqe 105.
- *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit të XX*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë 2019, faqe 76.
- *Lufta e Popullit shqiptar për çlirimin kombëtar 1918-1920*, Vëllimi II, dok. nr.23, f. 379-380, *Letër e Ministrisë së Punëve të Brendshme dërguar prefekturës së Vlorës*, Tiranë, 25 qershor 1920; po aty, dok. nr. 326, f. 381. *Urdhër i Ministrisë së Punëve të Brendshme dërguar Eshref Frashërit në Elbasan për nisjen e municioneve në Vlorë*, Tiranë, 28 qershor 1920.
- M. Montanari, *Le truppe italiane in Albania*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, faqe 214-215.
- *Mbi influencën e ideve të tetorit në Shqipëri*, Tiranë, 1957, faqe 52, 53.
- Paskal Milo, *Politika e Jashtme e Shqipërisë*, vëll. I (1912-1939), Toena, Tiranë 2013, faqe 416-417.
- *”Valona e nostra dhe Vlora e Shqipërisë”*, Gazeta “Drita”, Shtypur në Gjirokastrë më datë 6 maj 1920, faqe 1.
- Shyqyri Hysi, *Prefektura e Gjirokastrës në Luftën Kombëtare të Vlorës*, Edlora, Gjirokastrë, 2020, faqe 188.
- Zaho Golemi, Ëngjëllush Njazi Avdulaj, *Udhëheqja e Luftës së Vlorës në të gjitha nivelet nga këndshikimi pas 100 viteve*, Aktet e Konferencës Shkencore për 100 vjetorin e Luftës së Vlorës, faqe 5.